KQZ
U PROTOKOLLUA
NR. 317 PROT
DATE 07 3 2018

# PARTIA BASHKIMI PER TE DREJTAT E NJERIUT

Adresa: Bulevardi «Bajram Curri » nr. 32

Tel/Fax +355 423 77 921

Nr. *extra* prot.

Tiranë,me . 07 . 03 2018

**Lënda: Raport sqarues lidhur me të ardhurat dhe shpenzimet e Partisë Bashkimi për të Drejtat e Njeriut 2017**

**Drejtuar : Komisionit Qendror të Zgjedhjeve**

Me anë të kësaj shkrese ju bëjmë me dije qe bashkangjitur do të gjeni raportin sqarues lidhur me të ardhurat dhe shpenzimet e Partisë Bashkimi për të Drejtat e Njeriut 2017.

**Kryetari**

**Vangjel Dule**

# Raport sqarues lidhur me të ardhurat dhe shpenzimet të Partisë Bashkimi për të Drejtat e Njeriut të vitit 2017 (Vendim i KQZ-se dt 18.01.212)

## Struktura e Partise

Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut, e themeluar në Shkurt te vitit 1992, vazhdimisht ka qenë e përfaqësuar në Kuvendin e Shqipërisë dhe në të gjitha nivelet e pushtetit lokal.

Ajo është një Parti e organizuar dhe e strukturuar, si ne aspektin administrativ ashtu edhe në atë politiko-statusor.

Në zyrat e saj qendrore, në administratë punojnë: sekretari, financier-arketari, pastruesja (part-time). Struktura politiko-statusore e Partisë përfshin: Qendrën (Kryetari, Këshilli Drejtues, Kryesia, Sekretaret) si dhe degët e Partisë në rrethe (Kryetar dege, Këshilli, Kryesi..).

PBDNJ ka 33 dege ne mbare vendin edhe rreth 7800 antare.

PBDNJ ka lidhje të drejtpërdrejta me organizatën e gruas, të forumit rinor si dhe shoqatat e minoritetit etnik grek "Omonia", Unionin e Vleheve të Shqipërisë, kurse mban lidhje te tërthorta bashkëpunimi me shoqatat e romeve, te egjiptianeve, te serbo-malazezeve etj, meqenëse ato janë subjekte programore te alternatives politike që ajo mbron.

## Të ardhurat

Të ardhurat e Partisë Bashkimi për të Drejtat e Njeriut për vitin 2017 janë gjithsej 6,304,503 leke dhe përbëhen nga subvencione shtetërore:
Veç këtyre nga viti 2016 ka kaluar shuma prej 1,331,480 lekesh.

**Shpenzimet**

Shpenzimet gjatë vitit 2017 kapin shumën prej 5,016,741 lekesh dhe janë bërë për: 1. "**Shpenzime operative**" (pika 1.3 e lidhjes 2 te KQZ-së) dhe 2. "**shpenzime të tjera**".

1. **"Shpenzimet operative"** u përkasin nën ndarjeve të mëposhtme:

a) "**Shpenzime të perditshme për personelin**" që kap shumën prej 1.495.000 lekesh dhe janë bërë për rrogën e sekretarit teknik së Partisë, personelit me orar të reduktuar {llogaritarin, pastruesen dhe përgjegjësi për degët e Partisë në rrethe.

b) **"Shpenzime për ulilitete"- energji elektrike, gaz, lende djegëse, ujë, telefona dhe shpenzime të tjera të ngjashme",** që kap shumën prej 1,041,470 lekesh dhe janë bërë për të paguar energjinë elektrike, telefonat,internet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, taksen vendore, komisionet bankare, për konsum uji, blerje karburanti.

2. **<u>"Shpenzime të tjera"</u>** kap shumën prej 2,480,271 leke dhe janë bërë si më poshtë për:

| | |
|---|---|
| - Qira sallash dhe koktejle: | 232,020 leke |
| - Blerje materialesh kancelarie / higjienike / usb / boje printeri: | 42,450 leke |
| -Blerje e një TV | 55,700 leke |
| - Pagesa për taksi: | 17,700 leke |
| - Pagesa për printime / banera / filmime / fotografime / shërbime vizive/ përkthyesve: | 335,960 leke |
| -Blerje domain | 10,200 leke |
| -Pagesa për ushqim/fjetje në hotel: | 170,320 leke |
| -Pagesa për materiale hidraulike | 83,645 leke |
| -Pagesa për reklamim në facebook | 13,500 leke |
| -Blerje llampa ndriçimi: | 400 leke |
| -Pagesa për dërgim letrash dhe kartolina me poste | 2,560 leke |
| -Pagesa për shërbime noteriale | 3,800 leke |
| - Pagesa për shpenzime udhëtimi | 1,380,016 leke |
| - Pagesa për krasitje e një peme te zyrat e partisë: | 1,000 leke |
| - Blerje buqeta lulesh: | 5,000 leke |
| -Pagesa e kontabilistet për auditimin të ardhurave dhe shpenzimeve për vitin 2016: | 126,000 leke |

Tiranë, më 07.03.2018

Kryetari

Vangjel Dule